



Ndryshimet në Legjislacionin Tatimor

Korrik 2017

Në Korrik 2017, qeveria e Kosovës prezantoi ndryshimet e rëndësishme që janë bërë në sistemin tatimor vendor, ndryshime këto që reflektojnë në progresin e Kosovës për konsistencë me praktikën tatimore ndërkombëtare si dhe për integrimin e sistemit fiskal vendor në atë global.

Masat e ndërmarra adresojnë nevojën për transparencë tatimore, nevojën për përmirësimin e kushteve për investime, si dhe për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. Rrjedhimisht, ne presim që ndryshimet e fundit në përgjithësi të ndikojnë pozitivisht në ekonominë vendore.

Ndryshimet që shtjellohen më tej në këtë njoftim përfshijnë:

- Udhëzimin Administrativ MoF-No.02/2017 mbi Transferimin e Çmimit;
- Pakon Fiskale 2.0.

Shpresojmë që njoftimi është i dobishëm dhe informues për juve.

Ju lutëm na kontaktoni nëse keni nevojë të diskutojmë më gjerësisht në lidhje me ndryshimet, dhe se si këto ndryshime mund të ndikojnë në biznesin tuaj.

1. Transferimi i Çmimit

Udhëzimi Administrativ MoF- No.02/2017 mbi Transferimin e Çmimeve ("Udhëzimi") përcakton procedurat për administrimin dhe zbatimin të transaksioneve mes palëve të lidhura

Hyrje

Udhëzimi i TP-së është publikuar në kontekstin e përpjekjeve të Kosovës për të ndjekur trendet globale në trajtimin e shmangies së tatimore ndërkombëtare. Kështu Udhëzimi është hartuar në përputhje me Udhëzuesit e Transferimit të Çmimeve të OECD-së.

Udhëzimi hyri në fuqi më 28 Korrik 2017 dhe është i aplikueshëm për tatimpaguesit e tatimit në të ardhura të korporatave (TAK) të Kosovës të përfshirë në transaksione me palë të lidhura që janë subjekt të juridiksioneve të ndryshme. Kështu, kërkesat e parapara në Udhëzim do të ndikojnë më së shumti tatimpaguesit e Kosovës të cilët janë pjesë e një kompanie ndërkombëtare.

Udhëzimi ndjek parimin e tregut të OECD-së. Ky parim dikton që transaksioni me një palë të lidhur duhet të lidhet në kushte dhe rrethana të krahasueshme si një transaksion me një palë të pavarur.

Palë të Lidhura

Udhëzimi i TP-së parasheh që palët të konsiderohen si të lidhura në rast se ekzistonë një marrëdhënieje e veçantë ndërmjet tyre që mund të ndikojë materialisht në rezultatet ekonomike të transaksioneve ndërmjet tyre. Marrëdhëniet e palëve të lidhura përfshijnë:

- Një person mban ose kontrollon 50% ose më shumë të aksioneve ose të të drejtave të votes në shoqërinë e personit tjetër;
- Një person drejtpërdrejt ose tërthorazi kontrollon personin tjetër;
- Të dy personat kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një person i tretë;
- Personat janë të afërm të shkallës së parë, dytë apo të tretë.

***Vini re se Udhëzimi nuk është i zbatueshëm për transaksione të palëve të lidhura brenda Kosovës.**

Transaksionet e Kontrolluara

Termi transaksion i kontrolluara dhe transaksion ndërmjet palëve të lidhura zëvendësojnë njëri tjetrin në këtë Njoftim.

Një transaksion i kontrolluar për qëllime të Udhëzimit do të thotë marrëveshje, mirëkuptim, ose praktikë ndërmjet palëve të lidhura. Për më tepër, transaksionet e kontrolluara përfshijnë transaksionet e një tatimpaguesi të Kosovës me një person të vendosur në juridiksione të caktuara.

Në vlerësimin e transaksioneve të kontrolluara, edhe pse idealisht parimi i vlerës së tregut zbatohet në bazë të veç e veç për çdo transaksion, në realitet, transaksionet mund të jenë të lidhura aq ngushtë ose të jenë të vazhdueshme ashtu që ato të mos mund të vlerësohen në mënyrë adekuate ndaras.

Fushëveprimi i Udhëzimit

Kur palët e lidhura nxjerrin fitime në nivel mbi ose nën nivelin e krahasueshëm të tregut, vetëm për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis tyre (p.sh. duke ngarkuar çmime më të larta ose më të ulëta në krahasim me çmimet e tregut), fitimet nuk pasqyrojnë vlerën e reale të fitimeve në kushte të krahasueshme të tregut.

Në rastin e sipërpërmendur, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka të drejtë të bëjë ndryshime në fitimin e tatueshëm të një tatimpaguesi për të pasqyruar fitimin që përndryshe do të rrjedhte në kushte të krahasueshme të tregut ndërmjet palëve të pavarura (d.m.th. parimi i tregut).

Andaj, Udhëzimi përfundimisht shërben si udhërrëfyes për tatimpaguesit dhe ATK-në për të demonstruar se fitimi i tatueshëm i një tatimpaguesi të TAK-ut në Kosovës nuk ndikohet nga marrëdhënia e tij e veçantë me palët e lidhura.

Udhëzimi shërben si udhërrëfyes për të demonstruar se fitimi i tatueshëm i një tatimpaguesi të TAK nuk është ndikuar nga marrëdhënia e tij e veçantë me palë të lidhura.

Duke filluar nga viti fiskal 2017, tatimpaguesit e TAK mund t'i nënshtrohen dy kërkesave të mëposhtme (i) përgatitjen e dokumentacionit të TP-së dhe (ii) dorëzimin e Njoftimit Vjetor mbi transaksionet e kontrolluara

Dokumentacioni për TP

Tatimpaguesve u mbetet barra fillestare e provës se transaksionet me palët e lidhura janë konform parimit të tregut. Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione me palë të lidhura kërkohen që të përgatisin dokumentacionin që përmban elementet e përshkruara në Udhëzim.

1. Përmbledhja e aktiviteteve dhe skemës organizative të tatimpaguesit;
2. Përshkrimi i strukturës organizative dhe operacionale të grupit në të cilin tatimpaguesi është anëtar;
3. Përshkrimi i transaksioneve të kontrolluara dhe politikave të TP-së të zbatueshme;
4. Shpjegimi i arsyeve pse janë zgjedhur metodat e caktuara të TP-së dhe treguesit financiar;
5. Analiza e krahasueshmërisë;
 - o Përshkrimi i procesit të kryer për të identifikuar transaksionet e krahasueshme;
 - o Shpjegimin e bazës për refuzimin e çdo transaksioni të mundshëm të brendshëm të krahasueshëm dhe një përshkrim të transaksioneve të krahasueshme;
 - o Analiza e krahasueshmërisë së transaksioneve të kontrolluara dhe transaksioneve të krahasueshme të pakontrolluara;
 - o Detajet dhe shpjegimi i çdo rregullimi të kryer mbi krahasueshmërinë.
6. Shpjegimi i analizës ekonomike;
7. Detaje për çdo marrëveshje paraprake në lidhje me marrëveshjen e çmimeve;
8. Konkluzion në lidhje me përpuethshmërinë me parimin e vlerës së tregut.

Mos përgatitja e dokumentacionit në përputhje me Udhëzimin dhe mos dorëzimi do të rezultojë në ndëshkime administrative.

Megjithatë, rreziku më i madh nga mos-përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacionit, është mospërbushja e barrës fillestare të provës nga tatimpaguesi, me ç'rast ATK detyrohet të kryej një analizë vetë nga e para.

Përmbajtja e dokumentacionit e përshkruar më parë siguron elementet minimale të kërkuara për përmbushjen e kërkesave të dokumentacionit lokal.

Përndryshe, dokumentacioni i përgatitur sipas Kodit të Sjelljes së BE-së dhe anekset e tij mbi dokumentacionin e transferimit të çmimeve dhe Udhëzuesit të OECD-së (BEPS Action 13) gjithashtu konsiderohet të ketë përmbushur kërkesat lokale. Dokumentacioni i tillë përfshin së paku:

- Masterfile – Kjo dosje në përgjithësi përgatitet nga selia e grupit dhe ofron një pasqyrë mbi aktivitetet e grupit, si dhe marrëveshjeve signifikante për çmime ndërmjet kompanive.
- Localfile – dosje e përshtatur në mënyrë specifike për të trajtuar transaksionet ndër kompanive të një njësie vendore.

Dosjet së bashku përbëjnë dokumentacionin e TP-së dhe që të dyja i dorëzohen autoriteteve tatimore në rast të kërkesës.

Deloitte inkurajon tatimpaguesit të informojnë selinë e grupit lidhur me hyrjen në fuqi të udhëzimit të TP-së.

Është shumë e mundshme që një Masterfile tashmë është përgatitur dhe anëtarët e tjerë të grupit mund të kenë përgatitur një Local File (Dosje lokale). Cilado nga dosjet e mësipërme mund të zvogëlojë barrën e tatimpaguesit për dokumentacion.

Dorëzimi i Dokumentacionit të TP-së

Dokumentacioni i TP-së duhet të vihet në dispozicion të ATK-së 30 ditë pas kërkesës. Dokumentacioni dorëzohet në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe në rrethana të caktuara, ATK mund të pranojë dokumentacionin e përgatitur në gjuhën angleze.

Vini re se tatimpaguesit nuk janë të detyruar të dorëzojnë dokumentacionin e tyre të TP-së në ATK automatikisht siç është rasti në disa juridiksione.

Përveç përgatitjes së dokumentacionit të TP-së, tatimpaguesit e pëfshirë në transaksione me palë të lidhura në vlerë më tepër se EUR 300,000 në një vit fiskal duhet të dorëzojnë tek ATK një njoftim për transaksionet e tyre të kontrolluara vjetore.

Njoftimi vjetor

Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara në vlerë mbi EUR300,000 duhet të dorëzojnë tek ATK një njoftim mbi transaksionet e tyre vjetore me palët e ndërlidhura.

Njoftimi vjetor duhet të dorëzohet së bashku me deklaratën vjetore për TAK si dhe pasqyrat financiare.

Njoftimi Vjetor

Njoftimi i parë vjetor për transaksionet e kontrolluara do të dorëzohet brenda 31 Marsit 2018 për vitin 2017. Një mostër e informacionit që do të sigurohet në Njoftim përfshin:

- Informacionin mbi palën e lidhur;
- Kodi i aktivitetit (NACE Kodi);
- Vlera;
- Metoda e përdorur e TP-së;
- Informacion se a është përgatitur dokumentacioni.

Informata shtesë janë të nevojshme për huatë dhe transaksionet kapitale

Vini re që tatimpaguesit me transaksione të kontrolluara nën EUR 300,000 nuk janë të detyruar të dorëzojnë Njoftimin vjetor për transaksionet e kontrolluara.

Metodat e TP-së.

Tatimpaguesve u kërkohet të zgjedhin metodën më të përshtatshme për të përcaktuar natyrën e tregut për transaksionet e kontrolluara. Udhëzimi përcakton metodat e mëposhtme:

- Metoda e çmimit të krahasueshëm të pakontrolluar;
- Metoda e çmimit të rishitjes;
- Metoda kosto plus;
- Metoda e marzhit neto të transaksionit;
- Metoda e ndarjes së fitimit.

Tatimpaguesit duhet të shpjegojnë arsyen e zgjedhjes së një metode të veçantë në dokumentacionin e tyre.

Analiza e Krahasueshmërisë

Në procesin e identifikimit të transaksioneve të krahasueshme midis palëve të pavarura, tatimpaguesit duhet të marrin parasysh: (i) karakteristikat e mallrave/shërbimeve / pasurisë që krahasohen, (ii) funksionet e kryera dhe rreziqet e ndërmarra, (iii) marrëveshjet kontraktuale (iv) kushtet ekonomike si dhe (v) strategjinë biznesore.

Pra, të gjithë faktorët e mësipërm duhet të merren parasysh gjatë procesit të identifikimit të transaksioneve të krahasueshme.

Burime të Krahasueshme të të Dhënave

Udhëzimi i TP-së lejon përdorimin e dy burimeve për të dhëna të krahasueshme.

(i) Të Krahasueshme të Brendshme
Përfshin transaksionet mes tatimpaguesit dhe një pale të tretë të pavarur, të cilat janë të krahasueshme me transaksionet e kontrolluara. Vini re se transaksionet e brendshme, nëse janë në dispozicion, zakonisht konsiderohen më të besueshme për qëllime të TP.

(ii) Të Krahasueshme të Jashtme
Përfshin transaksione të krahasueshme midis dy palëve të pavarura. Transaksionet e jashtme të krahasueshme mund të jenë vendore (brenda Kosovës) ose te huaja.

Në praktikë është mjaft e vështirë të identifikohen transaksione të jashtme të krahasueshme brenda Kosovës për shkak të mungesës së informacioneve në dispozicion të publikut. Prandaj, transaksionet e jashtme të krahasueshme zakonisht identifikohen në tregjet e tjera gjeografike (BE ose Ballkan).

Dispozitat Përfundimtare

Dokumentacioni për TP i përgatitur për një vit fiskal, gjithashtu do të shërbejë si bazë për vitet në vijim nëse transaksionet janë të një natyre të përsëritur dhe kushtet ekonomike nuk ndryshojnë ndjeshëm. Sidoqoftë, nëse kërkohet një kërkim për transaksione të krahasueshme të jashtme, atëherë vlejnjë dispozitat si në vijim:

- Për tatimpaguesit që tejkalojnë EUR 300,000 në transaksione të kontrolluara brenda vitit fiskal, rezultatet financiare (treguesit financiar që rrjedhin nga kërkimi për transaksione të krahasueshme të jashtme) duhet të përditësohen në baza vjetore. Ndërsa një kërkim i plotë i ri për transaksione të krahasueshme duhet të kryhet çdo tre vjet.
- Tatimpaguesit me transaksione të kontrolluara nën EUR 300,000 nuk kanë nevojë të përditësojnë treguesit financiarë çdo vit. Megjithatë, këkesa për të kryer një kërkim të ri për transaksione të krahasueshme të jashtme çdo tre vjet mbetet.

2. Pako Fiskale 2.0

Qeveria e Kosovës Aprovon Pakon Fiskale 2.0

Çfarë Është Pako Fiskale 2.0

Pako Fiskale 2.0 është një sërë masash që Qeveria e Kosovës do t'i inkorporoj ne legjislacion si adresim ndaj nevojave dhe kërkesave te bizneseve lokale.

Shumë nga masat marrin sidomos parasysh nevojat e prodhueseve vendor, me qëllim që këta të fundit më konkurrues në tregun rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Në këtë pako janë përfshirë gjithsej njëzet e dy (22) masa të cilat prekin fusha të ndryshme tatimore duke përfshirë akcizën, tatimin mbi vlerën e shtuar, pushime tatimore si dhe masa të tjera jo tatimore si lehtësira të të bërit biznes në vend.

Aprovimi dhe Implementimi i Pakos

Pas shumë diskutimesh dhe disa shtyrjeve të vazhdueshme, Qeveria e Kosovës më në fund ka aprovuar Pakon e re Fiskale 2.0 më 17 Korrik 2017.

Implementimi i Pakos parashihet të bëhet gradualisht gjatë muajve të ardhshëm.

Ju lutem vini re se mund të ketë vonesa për implementimin e masave të përshkruara për shkaqe politike.

Disa nga masat janë paraparë të implementohen në muajin Korrik, mirëpo implementimi i tyre është shtyer

📌 Për më tepër Informacione ju lutem të na kontaktoni.

Përshkrimi i Masave

Në këtë seksion kemi përfshirë një përshkrim të secilës masë të pakos fiskale si dhe muajin e paraparë për implementim, Vini re që disa nga masat janë paraparë të implementohen në Korrik, mirëpo implementimi i tyre është shtyer. Ne kemi paraqitur informacionet në vijim në formë tabelare.

Masa e Pakos	Hyrja në Fuqi
1. Lirimi nga taksa doganore për të gjitha produktet që konsiderohen si lëndë e pare, sipas regjistrimit të prodhuesve në ATK	Tetor 2017
2. Heqja e normës së akcizës në mazut për prodhim	Korrik 2017
3. Plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës së reduktuar 8% të TVSH-së përfshirë aktivitetet kulturore, artistike, sportive, turistike, akomodim dhe rekreacion dhe përpunimi i peshkut	Shtator 2017
4. Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për Pushimet Tatimore për nxitjen e investimeve në sektor strategjik (agro-procesim, turizëm dhe IT) për periudhë të caktuar kohore	Shtator 2017
5. Nxjerrja e aktit legjislativ për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shënjimit të miellit që vendoset në qarkullim të lirë në tregun e Kosovës	Korrik 2017

Masa e Pakos	Hyrja në Fuqi
6. Nxjerrja e aktit nënligjor për kushtet e caktuara nën të cilat njihen humbjet nga prishja, avullimi apo humbja e peshës së naftës dhe produkteve me mundësi të njohjes së humbjeve në peshë edhe për produktet tjera	Korrik 2017
7. Krijimi i kodeve të reja tarifore për disa produkte, sipas praktikave të BE-së	Vazhdueshme
8. Krijimi i listës së rejtingut të kompanive	Rishikohet në baza vjetore
9. Licencat – krijimi i portalit të transparencës për kërkesa të bizneseve për licenca të ndryshme (transport, eksport, eksploatim etj.)	Korrik 2017
10. Fiskalizimi – avancimi i sistemit të fiskalizimit përmes platformës së re të TI	Janar 2018
11. Rishikimi i Ligjit për Lojërat e Fatit me qëllim të harmonizimit me praktikat më të mira ndërkombëtare për monitorim më të lehtë dhe formalizim të plotë të këtij sektori	Shtator 2017
12. Lista e prodhuesve vendor – nxjerrja e procedurave për lëshimin e autorizimit për prodhues vendor që mund të përfitojnë nga lirimet për inpute dhe makineri që përdoren në procesin e prodhimit	Rishikohet në baza vjetore
13. Plotësimi i Ligjit për Të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjit për të Ardhurat personale për të adresuar tatimin e kompanive të sigurimit dhe uljen e tatimit të mbajtur në burim për grumbulluesit e produkteve bujqësore	Janar 2018
14. Plotësimi i Ligjit për TVSH për të adresuar A) tatimin për aktivitetet e transportit rrugor ndërkombëtar të pasagjerëve për të siguruar trajtim të barabartë me transportin ajror dhe hekurudhor ndërkombëtar të pasagjerëve B) Trajtimin e skemave të veçanta për arin e investueshëm me qëllim që TVSH të përlogaritet vetëm për pjesën e punës së shpenzuar në stoli ndërsa ari I pastër nuk do të jetë pjesë e vlerës së tatueshme	Janar 2018
15. Trajtimi dhe rregullimi i importit të telefonave mobil përmes aktiviteteve të shtuara dhe të përbashkëta të ATK-së dhe Doganës së Kosovës (DK)	Shtator 2017
16. Rregullimi i tregut të shitjeve online. DK me platformë të re për kontrollim të shitjeve	Shtator 2017
17. Ulja e akcizës në pije të gazuara dhe jo të gazuara	Shtator 2017
18. Trajtimi i importit të pajisjeve prodhuese në formë parciale	Shtator 2017
19. Akciza në alkoolin etilik për përdorim në mjekësi	Shtator 2017
20. Trajtimi i mostrave me rastin e zhdoganimit	Vazhdueshëm
21. Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për skemën e veçantë për arin e investueshëm dhe tatimit vetëm për pjesën e punës dhe jo pjesës bazë të tregtimit të arit të pastër.	Janar 2018
22. Ruajtja e konkurrencës së derjtë përmes shqyrtimit të monopoleve potencial në treg përmes themelimit të Komisionit ndër-ministor për shqyrtimin e ankesave të bizneseve për monopoleve potenciale në treg.	Vazhdueshëm

Na Kontaktoni:

Afrore Rudi

Drejtoreshë | Tax and Legal

Tel: +381 38 760 329

Mobil: +386 49 590 807

Email: arudi@deloittece.com

Leonik Mehmeti

Konsulent i Lartë | Transfer Pricing

Tel: +381 38 760 363

Mobil: +386 49 398 936

Email: lmehmeti@deloittece.com

Ruzhdi Zenelaj

Menagjer | Tax and Legal

Tel: +381 38 760 348

Mobil: +386 49 283 105

Email: rzenelaj@deloittece.com

Gjon Aliaj

Menagjer | Tax and Legal

Tel: +381 38 760 315

Mobil: +386 49 780 714

Email: galiaji@deloittece.com

Visar Kabashi

Menagjer | Tax and Legal

Tel: +381 38 760 337

Mobil: +386 49 737785

Email: vkabashi@deloittece.com



Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.deloitte.com

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte ka mundësinë globale dhe ekspertizën e thellë lokale për të ndihmuar klientët të jenë të suksesshëm kudo që ata operojnë. Për të mësuar më shumë rreth mënyrës se si pothuajse 245,000 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë, ju lutem lidhuni me ne në [Facebook](https://www.facebook.com/deloitte), [LinkedIn](https://www.linkedin.com/company/deloitte), ose [Twitter](https://www.twitter.com/deloitte).

Deloitte Central Europe është një organizatë rajonale e entiteve të organizuara nën ombrellën e Deloitte Central Europe Holdings Limited, firma anëtare në Evropën Qendrore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Shërbimet ofrohen nga filialet e Deloitte Central Europe Holdings, të cilat janë persona juridikë të ndarë dhe të pavarur.